



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**6 nëntor 2017, Prishtinë,
Ref:09.10.2017\569-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Devolli Group kundër Kosovës Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31 tetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "VV rrëshqet në batakun e PDK-së" të datë 27.09.2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se gazeta Kosova Sot duke u mbështetur në prononcimet e analistëve të vet, nxjerr një varg akuzash kundër Devollëve, si "bandë kriminale serbiane", "bandë famkeqe serbo-çetnike që quhet Devolli, e që janë të lidhur me VV-në". Gjithashtu thuhet se "Devollët janë ajka e krimit".

Të gjitha këto akuza nuk mbështeten në fakte në mënyrën që të jenë të besueshme. Këto epitete nuk mund të pranohen pa u mbështetur në fakte. Ato janë të thëna nga analistët, gjë që Kodi i Mediave të Shkruara nuk i mbështetë nëse fyejnë dhe shpifin pa fakte.

Në këtë mënyrë, Bordi i KMSHK vendosi se është shkelur Kreu II (Raportimi i së vërtetës), dhe Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur), pasi gazeta nuk i ka mundësuar palës tjetër të prononcohet fare lidhur me këto akuza.

Opinionin u nxor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMSHK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionin.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës